b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### Skicimet, parametrat teknik etj:

##### 1. Sapun i lëngshëm duarsh

Ky produkt të jetë me efekt shkumues të menjëhershëm dhe të realizojë pastrim efikas të duarve falë përqendrimit të duhur të tensioaktivëve anionikë. Produkti duhet që pas përdorimit t'i lerë duart të hidratuara pas përdorimit falë agjentëve të tij emolientë.

Karakteristikat teknike minimale:

Të ketë në përbërje të paktën:

- Tensioaktivë jo-jonikë 1- 2% të vëllimit të produktit.
- Tensioaktivë anionikë  $\geq 5\%$  të vëllimit të produktit.
- Tensioaktivë kationikë  $\leq 1\%$  të vëllimit të produktit.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5 -1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

##### 2. Solucion për dezinfektimin e mobiljeve

Ky produkt duhet të përdoret për higjienizimin e sipërfaqeve të ndryshme të mobiljeve, dyerve, dritareve, bankave, katedrave etj. Produkti duhet të higjienizojë në mënyrë të sigurtë sipërfaqet e ndryshme duke pasur në përbërje të tij tensioaktivë jo-jonikë dhe përbërës të tjerë të cilët rrisin gamën e veprimit të tij në sa më shumë faktorë mikrobiotikë, viralë dhe fungicidë.

---

Karakteristikat teknike minimale:

Të ketë në përbërje të paktën:

- Tensioaktivë jo-jonikë 1- 2% të vëllimit të produktit.
- Tensioaktivë anionikë 1- 2% të vëllimit të produktit.
- Tensioaktivë kationikë  $\leq 1\%$  të vëllimit të produktit.
- Etanol  $\leq 0.2\%$  të vëllimit të produktit.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5-1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **3. Solucion dezinfektant me bazë alkooli**

Ky produkt duhet të përdoret me efikasitet dhe në dezinfektimin e instrumenteve, pajisjeve të palestrave, pajisjeve të kabineteve mësimorë etj. Gjithashtu ky produkt me bazë alkooli duhet të përdoret për higjenizimin e duarve falë agjentëve të tij emolientë me bazë bimore, në të gjitha situatat kur kërkohet pastrimi dhe higjenizimi i duarve pa qenë i nevojshëm përdorimi i ujit dhe sapunit. Produkti duhet të higjenizojë në mënyrë të sigurtë duke pasur në përbërje të tij alkool etilik dhe përbërës të tjerë të cilët rrisin gamën e veprimit të tij në sa më shumë faktorë mikrobiotikë, viralë dhe fungicidë. Produkti duhet të thahet në mënyrë të shpejtë pas përdorimit.

Karakteristikat teknike minimale:

- Të ketë prezencë në jo më pak se 60% të vëllimit të produktit alkool etilik.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5-1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **4. Xhel antiseptik për higjenizimin e duarve**

Ky produkt alkoolik xhel, të jetë me efekt antiseptik për higjenizimin e duarve duke vepruar me efikasitet kundër faktorëve mikrobialë, viralë dhe fungicidë. Produkti duhet të thahet në mënyrë të shpejtë në ajër dhe t'i lerë duart të hidratuara pas përdorimit falë agjentëve të tij emolientë.

Karakteristikat teknike minimale:

- Të ketë prezencë në jo më pak se 60% të vëllimit të produktit alkool etilik.
- Të ketë në përbërje jo më pak se një produkt emolient me bazë bimore.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5 - 1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **5. Vasketa inoksi për dezinfektimin e këpucëve**

Vasketa inoksi të cilat do të montohen në hyrje të objekteve arsimore dhe publike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor me qëllim dezinfektimin e këpucëve para hyrjes në objekt.

Karakteristikat teknike minimale:

Spesori: jo më pak se 0.8mm

---

Lloji i materialit: çelik i pandryshkshëm inoks AISI 304 ose ekuivalent  
Dimensionet: Gjatësia 100 cm ± 5cm x Gjerësia 60cm ± 2 cm x Thellësia 5cm ± 0.5cm

Tehet e vasketës të jenë të kthyer nga brenda 180°, jo më pak se 2.5 cm tek të gjitha kahet, për të eliminuar ndonjë dëmtim të mundshëm gjatë shkeljes. Çdo vasketë të shoqërohet secila me vida/fasheta fiksuese për fiksimin në dysheme dhe ruajtjen e produktit nga dëmtimi dhe rrjedhjet e mundshme dhe me një sfungjer me dendësi të lartë me karakteristikat teknike të përcaktuara për produktin me nr.6 në tabelën e Shtojcës 5. Të ofrohet me garanci të paktën 12 muaj nga koha e lëvrimit.

## **6. Sfungjer për vasketat e inoksit**

Sfungjeri duhet të ketë përmbajtje polimeri poliuretani. Çdo sfungjer duhet të shoqërohet me lëndën ngjitëse që do të bëjë të mundur ngjitjen e sfungjerit me tabanin e vasketës. Lënda ngjitëse duhet të sigurojë një ngjitje të sigurtë duke garantuar mos shkëputjen pas ngopjes së sfungjerit me solucion dhe përdorimit të saj në shkelje.

Sfungjeri duhet të jetë me dendësi të lartë me karakteristikat teknike si më poshtë:

Densiteti:  $\geq 50 \text{ kg/m}^3$   
Fortesia:  $\geq 70\text{N}$   
Zgjatimi:  $\geq 80\%$   
Rezistenca:  $\geq 50\text{kPa}$

Sfungjeri të ketë përmasa, sipas dimensioneve të vasketës (produkti me nr.5 në tabelën e Shtojcës 6):

Gjatësia: 100 cm ± 5cm  
Gjerësia: 60cm ± 2 cm  
Trashësia: 2-3 cm

## **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi bëhet me mjetet e furnizuesit në çdo objekt parashkollor dhe shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nënshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Sapun lëng për duart	litra	50 009
2	Solucion dezinfektant për mobiljet	litra	18 227
3	Solucion dezinfektant me bazë alkooli	litra	4 264
4	Xhel antiseptik për higjenizimin e duarve	litra	50 009
5	Vasketa inoksi për dezinfektimin e këpucëve	copë	6
6	Sfungjer për vasketat e inoksit	copë	1 177

#### Afatet e lëvrimit:

Artikulli Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Sapun lëng për duart	litra	50 009	DPOP	12 muaj
2	Solucion dezinfektant për mobiljet	litra	18 227	DPOP	12 muaj
3	Solucion dezinfektant me bazë alkooli	litra	4 264	DPOP	12 muaj
4	Xhel antiseptik për higjenizimin e duarve	litra	50 009	DPOP	12 muaj
5	Vasketa inoksi për dezinfektimin e këpucëve	copë	6	DPOP	12 muaj
6	Sfungjer për vasketat e inoksit	copë	1 177	DPOP	12 muaj

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

**Grafiku i lëvrimit të mallit** do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

**Vendodhjet e objekteve shkollore dhe parashkollore të Bashkisë Tiranë në zonën urbane sipas adresave përkatëse:**

<b>Nr</b>	<b>Nj. Adm.</b>	<b>Objekti Arsimor Shkolla</b>	<b>Adresa</b>
1	<b>NJ ADM NR 1</b>	Shkolla e Mesme "Abdulla Keta"	Shkoze / Nj.B.Nr.1
2		Shkolla 9-Vjecare "Ali Demi"	Rr. Ali Demi/ Nj.B.Nr.1
3		Shkolla 9-Vjecare "Kushtrimi i Lirise "	Rr. Gani Domi/ Nj.B.Nr.1
4		Shkolla 9-Vjecare "1- Maji"	Rr. Ali Demi/ Nj.B.Nr.1
5		Shkolla 9-Vjecare "Androkli Kostallari "	Shkoze/ Nj.B.Nr.1
6		Shkolla 9 - vjecare "Androkli Kostallari i Ri"	Shkoze/ Nj.B.Nr.1
1	<b>NJESIA ADMINISTRATIVE NR 2</b>	Shkolla e Mesme "Ismail Qemali"	Rr. Marsel Kashen / Nj.B.Nr.2
2		Shkolla e Mesme "Sander Prosi"	Sauk / Nj.B.Nr.2
3		Shkolla 9-Vjecare "Fan Noli"	Rr. Qemal Stafa / Nj.B.Nr.2
4		Shkolla 9-Vjecare " Mihal Grameno"	Rr. Mihal Grameno / Nj.B.Nr.2
5		Shkolla 9-Vjecare " Hoxha Tasim "	Rr. Hoxha Tasim / Nj.B.Nr.2
6		Shkolla 9-Vjecare "Osman Myderizi"	Rruga Budi / Nj.B.Nr.2
7		Shkolla 9-Vjecare "Mustafa Greblleshi"	Sauk / Nj.B.Nr.2
8		Shkolla 9-Vjecare "Qemal Atatürk "	Sauk / Nj.B.Nr.2
9		Shkolla 9-Vjecare "Ibrahim Brahja "	Sauk i Vjeter / Nj.B.Nr.2
10		Shkolla 9-Vjecare "Kosova "	Rr. Labinoti / Nj.B.Nr.2
11		Shkolla e Mesme "Asim Vokshi"	Rr.E.Elbasanit
12		Shkolla e Mesme "Jordan Misja"	Rr E Elbasanit
13		Shkolla e Baletit	Rr E Elbasanit
1	<b>NJ ADM NR 3</b>	Shkolla e Mesme "Andon Z.Cajupi"	Rr. Kongresi i Mnanastirit/ Nj.B.Nr.3
2		Shkolla 9-Vjecare " Hasan Prishtina "	Rr. Qemal Stafa/ Nj.B.Nr.3
3		Shkolla 9-Vjecare "Xhezmi Delli "	Rr. Xhezmi Delli/ Nj.B.Nr.3
4		Shkolla 9-Vjecare "Kongresi i Lushnjes "	Rr. Qemal Stafa/ Nj.B.Nr.3
5		Shkolla 9-Vjecare "Niket Dardan"	Rr. Arkitekt Sinani/ Nj.B.Nr.3
1	<b>NJ ADM NR 4</b>	Shkolla e Mesme "Eqerem Cabej"	Rruga e Dibres / Nj.B.Nr.4
2		Shkolla 9-Vjecare "Gjon Buzuku"	Rr. Kongresi I Manastirit/ Nj.B.Nr.4
3		Shkolla 9-Vjecare " Ramazan Jarani"	Rr. Niko Avrami/ Nj.B.Nr.4
4		Shkolla 9-Vjecare " Bajram Curri "	Rruga e Dibres/ Nj.B.Nr.4
5		Shkolla 9-Vjecare " Pal Engjell1"	Rr. Reparti ushtarak 3700/ Nj.B.Nr.4
6		Shkolla 9-Vjecare " Ardian Klosi"	Rr. Selaudin Bekteshi Nj.B.Nr.4
1	<b>NJ ADM NR 5</b>	Shkolla e Mesme "Besnik Sykja"	Rr. Bajram Curri / Nj.B.Nr.5
2		Shkolla e Mesme "Petro N. Luarasi"	Rr. Sami Frasheri / Nj.B.Nr.5
3		Shkolla 9-Vjecare "Deshmoret e Lirise"	Rr. Zef Jubani/ Nj.B.Nr.5
4		Shkolla 9-Vjecare "Edith Durham"	Rr. Sami Frasheri/ Nj.B.Nr.5

5		Shkolla 9-Vjecare "Emin Duraku"	Rr. Gjin Bue Shpata/ Nj.B.Nr.5
6		Shkolla 9-Vjecare "26- Nentori"	Rr. Irfan Tomini/ Nj.B.Nr.5
7		Shkolla 9-Vjecare "Vasil Shanto"	Rr. Bajram Curri/ Nj.B.Nr.5
8		Shkolla 9-Vjecare "Murat Toptani "	Selit/ Nj.B.Nr.5
9		Shkolla 9-Vjecare "At Zef Pellumbi "	Tirane e Re / Nj.B.Nr.5
1	NJ ADM NR 6	Shkolla e Mesme " Myslym Keta "	Rr. Llambi Bonata /Nj.B.Nr.6
2		Shkolla 9-Vjecare " Lasgush Poradeci"	Rr. Petraq Leka/ Nj.B.Nr.6
3		Shkolla 9-Vjecare "Shyqyri Peza "	Rr. Hamdi Cenoymeri /Nj.B.Nr.6
4		Shkolla 9-Vjecare " 1- Qershori "	Rr. Frano Bardhi / Nj.B.Nr.6
5		Shkolla 9-Vjecare " Musine Kokalari "	Rr. Llazi Miho Kombinat / Nj.B.Nr.6
6		Shkolla 9-Vjecare " Kongresi i Manastirit "	Rr. 3 Deshmoret / Nj.B.Nr.6
7		Shkolla 9-Vjecare " Betim Muço"	Rr. 3 Deshmoret / Nj.B.Nr.6
1	NJ ADM NR 7	Shkolla e Mesme "Arben Broci"	Rr. Besim Imami/ Nj.B.Nr.7
2		Shkolla 9-Vjecare "Naim Frasheri "	Rr. Frosina Plaku/ Nj.B.Nr.7
3		Shkolla 9-Vjecare "Pjeter Budi "	Rr. Myslym Shyri/ Nj.B.Nr.7
4		Shkolla 9-Vjecare "Sabaudin Gabrani "	Rr. Muhamet Gjollasha/ Nj.B.Nr.7
5		Shkolla 9-Vjecare "Dhora Leka "	Fusha e Aviacionit/ Nj.B.Nr.7
6		Shkolla 9-Vjecare "Gustav Mayer"	Rr. Frosina Plaku/ Nj.B.Nr.7
7		Shkolla 9-Vjecare "Drita Pelingu"	(N.SH.R.A.K)/ Nj.B.Nr.7
1	NJ ADM NR 8	Shkolla e Mesme "Partizani "	Rr. 4 Deshmoret /Nj.B.Nr.8
2		Shkolla 9-Vjecare "Misto Mame"	Rruga e Dibres /Nj.B.Nr.8
3		Shkolla 9-Vjecare "Skender Çaçi"	Rruga e Dibres / Nj.B.Nr.8
4		Shkolla 9-Vjecare "4 Deshmoret"	Rr. 4- Deshmoret/Nj.B.Nr.8
5		Shkolla 9-Vjecare "Siri Kodra"	Rr. Siri Kodra/Nj.B.Nr.8
6		Shkolla 9-Vjecare "Shkolla e Kuqe"	Rr. Qemal Stafa/Nj.B.Nr.8
1	NJ ADM NR 9	Shkolla e Mesme "Sami Frasheri"	Rruga e Barikadave /Nj.B.Nr.9
2		Shkolla e Mesme "Sinan Tafaj "	Rruga " Fortuzi"
3		Shkolla 9-Vjecare "Hasan Vogli"	Rr. Haxhi Dalliu/Nj.B.Nr.9
4		Shkolla 9-Vjecare "Lidhja e Prizrenit "	Rruga e Barikadave/Nj.B.Nr.9
5		Shkolla 9-Vjecare "Qazim Turdiu "	Rr. Jordan Misja/Nj.B.Nr.9
6		Shkolla 9-Vjecare "7- Marsi"	Rr. Konferenca e Pezes/Nj.B.Nr.9
7		Shkolla 9-Vjecare "Jeronim de Rada"	Rruga Furtuzi / Nj.B.Nr.9
8		Shkolla 9-Vjecare "Servete Maci"	Rruga e Dibres/Nj.B.Nr.9
9		Shkolla 9-Vjecare "Migjeni "	Rr. Mahmut Fortuzi/ Nj.B.Nr.9
1	NJ ADM NR 10	Shkolla e Mesme "Qemal Stafa"	Rr. Kongresi i Permetit /Nj.B.Nr.10
2		Shkolla e Mesme "Kristoforidhi"	Rr. Shyqyri Berxolli/Nj.B.Nr.10
3		Shkolla 9-Vjecare "Avni Rustemi"	Rr. Andon Z. Cajupi /Nj.B.Nr.10
4		Shkolla 9-Vjecare "Dora D'istia"	Rr. Myslym Shyri /Nj.B.Nr.10
5		Shkolla 9-Vjecare "Konferenca e Pezes"	Rr. Him Kolli /Nj.B.Nr.10

1	<b>NJ ADM NR 11</b>	Shkolla e Mesme "Aleks Buda"	Laprake/Nj.B.Nr.11
2		Shkolla 9-Vjecare "Ahmet Gashi"	Rr. Pandi Dardha/Nj.B.Nr.11
3		Shkolla 9-Vjecare "28-Nentori"	Rr. Pandi Dardha /Nj.B.Nr.11
4		Shkolla 9-Vjecare "Isa Boletini"	Kamez/Nj.B.Nr.11
5		Shkolla 9-Vjecare "Kol Jakova"	Bregu i Lumit /Nj.B.Nr.11
6		Shkolla 9-Vjecare "Skender Luarasi"	Rr. Vangjel Noti /Nj.B.Nr.11
7		Shkolla 9-Vjecare "Gjerg Fishta"	Rr.Bregu I Lumit/Nj.B.Nr.11

**Vendohjet e objekteve shkollore dhe parashkollore të Bashkisë Tiranë në zonën rurale sipas adresave përkatëse:**

<b>Nr</b>	<b>Njesia Admin</b>	<b>Fshati/Shkolla</b>	<b>Emertimi</b>
1	<b>ZALL-HERR</b>	CERKEZ MORINE	Shkolla 9-vjecare "Kasalle",
2		CERKEZ MORINE	Shkolla 9-vjecare 'Çerkeze',
3		DRITAS	Shkolla 9 Vjeçare "Dritas,
4		HERRAJ	Shkolla 9 -Vjeçare "Herraj,
5		KALLMET	Shkolla 9 -Vjeçare "Kallmet
6		PINAR	Shkolla 9 -Vjeçare "Pinar "
7		PINAR	Shkolla 9 -Vjeçare "Pinar Melciz"
8		ZALL-HERR	Shkolla 9 -Vjeçare "Mustafa Kemal Ataturk"
9		ZALL-HERR	Shkolla e Mesme, " Mustafa Kemal Ataturk"
10		PRISKE E VOGEL	Shkolla 9 -Vjeçare"Priske E Vogel
11		QINAM	Shkolla 9 -Vjeçare "Qinam"
1	<b>BALDUSHK</b>	BALDUSHK	Shkolla 9 -Vjeçare "Lilaj",
2		BALDUSHK	Shkolla e Mesme e bashkuar "Baldushk, Feti Vogli
3		FUSHAS	Shkolla 9 -Vjeçare "Fushas
4		ISUF MUCAJ	Shkolla 9-Vjeçare"Isuf Muçaj,
5		KOCAJ	Shkolla 9 -Vjeçare"Koçaj,
6		MUSTAFA KOCI	Shkolla 9 -Vjeçare"Mustafa Koçi,
7		PARRET	Shkolla 9 -Vjeçare"Parret,
8		SHENKOLL-PARRET	Shkolla 9 -Vjeçare"Shenkoll-Parret,
9		SHPAT	Shkolla 9 Vjeçare "Shpat, (Baldushk,Tirane)"
10		TAVAREN	Shkolla 9 -Vjeçare "Tavaren"
11		VESQI	Shkolla 9 -Vjeçare "Vesqi"
12		VRAP	Shkolla 9 -Vjeçare "Vrap"



1	BERZHITE	BERZHITE	Shkolla 9 -Vjeçare "Berzhite" Selman Meta	
2		DOBRESH	Shkolla 9-vjecare "Dobresh", 9 Vjeçare	
3		FRAVESH	Shkolla 9 -Vjeçare "Fravesh"	
4		IBE E POSHTME	Shkolla e Mesme e Bashkuar 'Mersin Duqi'	
5		IBE E SIPERME	Shkolla 9 -Vjeçare 'Vaid Haka'	
6		KLLOJKE	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Kllojke	
7		MIHAJAS	Shkolla 9 Vjeçare 'Xhemal Hida'	
8		PELLUMBAS	Shkolla 9 Vjeçare "Pellumbas"	
9		PESHKASHESH	Shkolla 9-Vjeçare "Pashkashesh"	
1	DAJT	BRAR	Shkolla 9-Vjeçare "Brar"	
2		DARSHEN	Shkolla 9-Vjeçare "Darshen"	
3		FERRAJ	Shkolla 9 Vjeçare "Ferraj"	
4		LANABREGAS	Shkolla 9 Vjeçare "Lanabregas"	
5		LINZE	Shkolla 9-vjecare "17 Shkurti" Qesarake e Re	
6		LINZE	Shkolla 9 -Vjeçare "17 Shkurti" Qesarake e Vjeter Linze,	
7		MURTH	Shkolla 9-Vjeçare "Murth,"	
8		PRISKE E MADHE	Shkolla 9-vjecare 'Flamur Shkoza'	
9		SELBE	Shkolla 9-Vjeçare "Selbe"	
10		SHKALLE	Shkolla 9 Vjeçare 'Ejona Dinga'	
11		SHTISHTUFINE	Shkolla 9 Vjeçare "Shtishtufine"	
12		SURREL	Shkolla e Mesme Bashkuar 'Ymer Lala'	
13		TUJAN	Shkolla 9-vjecare "Tujan"	
1	FARKE	FARKE E MADHE	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Farke E Madhe,	
2		FARKE E VOGEL	Shkolla 9-vjecare "Farke E Vogel"	
3		LUNDER	Shkolla 9-vjecare "Lunder"	
4		MJULL BATHORE	Shkolla 9-vjecare "Mjull Bathore"	
5		SELITE	Shkolla 9-vjecare "Selite "	
1	KASHAR	KASHAR	Shkolla e Mesme e Bashkuar "100 Vjetori Pavaresise"	
2		KASHAR-KODER	Shkolla 9-vjecare "Kashar Koder" Mustafa Lleshi	
3		KATUND I RI	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Sadik Stavileci"	
4		KATUND I RI	Shkolla 9-vjecare "Katund I Ri, 9 Vjeçare "	
5		KUS	Shkolla 9-vjecare "Kus"	
6		MEZEZ-KODER	Shkolla 9-vjecare "Kasem Shima"	
7		MEZEZ-FUSHE	Shkolla 9-vjecare "Mezez - Fushe"	

8		YRSHEK	Shkolla 9-vjecare "Yrshek"	
9		YZBERISH	Shkolla 9-vjecare "Yzberish, 9 Vjeçare"	
10		MAZREK	Shkolla C.U. "Lule Mazrek"	
11		YZBERISH	Shkolla e Mesme e Pergjithshme "Myslym Shima"	
1	<b>KRRABE</b>	KRRABE	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Krrabe"	
2		KRRABE	Shkolla 9-vjecare "Krrabe"	
3		MUSHQETA	Shkolla 9-vjecare "14 Nentori"	
4		SKUTERRE	Shkolla 9-vjecare" (Krrabe Tirane)	
1	<b>NDROQ</b>	KERCUKJE	Shkolla 9-vjecare"Kerçukje"	
2		LAGJA E RE	Shkolla 9-vjecare "Ymer Kurti "	
3		MENIK	Shkolla 9-vjecare "Menik (Ndroq, Tirane)"	
4		NDROQ	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Sadi Nuri"	
5		NDROQ	Shkolla 9-vjecare "Ndroq" Bashkim Berisha"	
6		NDROQ	Shkolla 9-vjecare 'Ismajle"	
7		NDROQ	Shkolla 9-vjecare 'Seit Brahja (Ndroq,Tirane)"	
8		PINET	Shkolla 9-vjecare "Pinet"	
9		SAUQET	Shkolla 9 Vjeçare "Sauqet, (Ndroq,Tirane)"	
10		SHESH	Shkolla 9-vjecare "Shesh"	
11		NDROQ	Shkolla 9-vjecare "Gerbllesh "	
12		NDROQ	Shkolla 9-vjecare "Kalace "	
13		ZHURJE	Shkolla 9-vjecare "Zhurje "	
1	<b>PETRELE</b>	DAIAS	Shkolla 9-vjecare 'Nexhmi Tafaj"	
2		FIKAS	Shkolla 9-vjecare "Fikas"	
3		GURRE	Shkolla 9-vjecare 'Qamil Balla"	
4		HEKAL	Shkolla 9-vjecare "Hekal"	
5		MANGULL	Shkolla 9-vjecare "Mangull "	
6		MULLET	Shkolla e Mesme e Pergjithshme 'Ibrahim Hasmema"	
7		MULLET	Shkolla 9-vjecare"Sami Kalasa"	
8		PETRELE	Shkolla 9-vjecare'Haki Shehu"	
9		PICALLE	Shkolla 9-vjecare "Ramazan Dervishi "	
10		STERMAS	Shkolla 9-vjecare "Stermas "	
11		TAGAN	Shkolla 9-vjecare "Tagan "	
1	<b>PEZE</b>	DOREZ	Shkolla 9-vjecare "Dorez"	
2		GJYSYLKONJE	Shkolla 9-vjecare "Gjysylkonje"	
3		MAKNOR	Shkolla 9-vjecare "Maknor"	

4		PAJANE	Shkolla 9-vjecare "Pajane	
5		PEZE	Shkolla e Mesme e Bashkuar '16 Shtatori'	
6		PEZE	Shkolla 9-vjecare '16 Shtatori'	
7		PEZE E VOGEL	Shkolla 9-vjecare "Peze E Vogel"	
8		PEZE HELMES	Shkolla 9-vjecare "Peze Helmes"	
1	<b>SHENGJERGJ</b>	BURIMAS	Shkolla 9-vjecare "Vesel Tila"	
2		FACESH	Shkolla 9-vjecare "Façesh"	
3		FAG	Shkolla 9-vjecare "Fag"	
4		PARPUNJE	Shkolla 9-vjecare "Parpunje"	
5		SHENGJERGJ	Shkolla 9-vjecare "Shengjergj"	
6		SHENGJIN	Shkolla 9-vjecare "Shengjin"	
7		URE	Shkolla 9-vjecare "Ure"	
8		VAKUMONE	Shkolla 9-vjecare "Vakumone"	
9		VERRI	Shkolla e Mesme e Bashkuar 'Xhelal Shtepani'	
1	<b>VAQARR</b>	ALLGJATE	Shkolla 9-vjecare "Allgjate"	
2		ARBANE	Shkolla 9-vjecare 'Mihal Duri'	
3		DAMJAN	Shkolla 9-vjecare "Damjan "	
4		GROPAJ	Shkolla 9-vjecare "Gropaj"	
5		LALM	Shkolla 9-vjecare "Lalm"	
6		SHARRE	Shkolla 9-vjecare "Sharre"	
7		VAQARR	Shkolla e Mesme e Bashkuar "Vaqarr"	
8		VAQARR	Shkolla 9-vjecare Bedri Llagami	
9		VISHAJ	Shkolla 9-vjecare "Vishaj"	
1	<b>ZALL-BASTAR</b>	BASTAR I MESEM	Shkolla 9-vjecare "Bastar i Mesem"	
2		BASTAR I MESEM	Shkolla 9-vjecare 'Hasnukje'	
3		BASTAR MURRIZE	Shkolla 9-vjecare "Bastar Murrize"	
4		BESH	Shkolla 9-vjecare "Besh"	
5		DAJT	Shkolla 9-vjecare "Dajt"	
6		MENER I SIPERM	Shkolla 9-vjecare "Mener i Siperem"	
7		MENER I SIPERM	Shkolla 9-vjecare "Mal Pjeç"	
8		MENER I SIPERM	Shkolla 9-vjecare "Mal Gjepal"	
9		MOJSIT	Shkolla 9-vjecare "Mojsit"	
10		ZALL-BASTAR	Shkolla 9-vjecare "Kutreq"	
11		SELITE E MALIT	Shkolla 9-vjecare "Selite E Malit"	
12		ZALL-BASTAR	Shkolla 9-vjecare "Shengjin"	

---

<b>13</b>	VILEZ	Shkolla 9-vjecare "Vilez,	
<b>14</b>	VILEZ	Shkolla 9-vjecare "Mal Vilez"	
<b>15</b>	ZALL DAJT	Shkolla 9-vjecare "Shupal"	
<b>16</b>	ZALL DAJT	Shkolla 9-vjecare "Zall Dajt"(Hamdi Mancaku)	
<b>17</b>	ZALL DAJT	Shkolla 9-vjecare "Kurth"	
<b>18</b>	ZALL-BASTAR	Shkolla e Mesme e Bashkuar" Bahri Nela"	
<b>19</b>	ZALL-BASTAR	Shkolla 9-vjecare "Maricaj"	
<b>20</b>	ZALL-BASTAR	Shkolla 9-vjecare "Shyqyrk"	

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**2.1.2** Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Shënim: Ky kriter (2.1.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.1.3** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

---

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi solucione dezinfektantë dhe antiseptikë (produktet me nr.1, 2, 3, 4 në tabelën e Shtojcës 6), duhet të paraqesë skedat teknike të sigurisë (MSDS) të publikuara nga prodhuesi/it dhe fletë analizat të lëshuara nga laboratorë të akredituar me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

---

*Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues për këtë kriter dhe vërtetimi i akreditimit të laboratorit që ka lëshuar fletë analizën do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues merr përsipër me mjetet e veta dhe me punonjësit e vet të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në të gjitha objektet shkollorë nën administrim të autoritetit kontraktor në territorin e Bashkisë së Tiranës sipas grafikut të lëvrimit dhe planit të shpërndarjes i cili do t'i vihet në dispozicion nga autoriteti kontraktor ditën e lidhjes së kontratës.

*Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues (deklaratë me shkrim) do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qera të paktën 2 (dy) automjete ATP (automjet i transportit të përzier). Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin të vlefshme, ose në rast se i merr automjetet me qira të paraqesë kontratën e qirasë dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin) të vlefshme.

*Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë në përputhje me produktet e ofruara dhe specifikimet teknike të kërkuara.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



## Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>	<b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

<p>të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
